

VENDIM
Nr.56, datë 3.2.1997

PËR PAGESËN E PUNONJËSVE TË SHOQËRISË ANONIME “SHEQERI” NË MALIQ, TË CILËT DALIN TË PAPUNË NGA NDËRPRERJA E VEPRIMTARISË PRODHUESE TË KËSAJ SHOQËRIE

Për të rregulluar pagesat e punonjësve të shoqërisë anonime “Sheqeri” në Maliq, të cilët dalin të papunë nga ndërprerja e veprimtarisë ekonomike të kësaj shoqërie, me propozimin e Ministrisë së Punës dhe të Çështjeve Sociale, të Ministrisë së Privatizimeve dhe të Ministrisë së Bujqësisë e të Ushqimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Punonjësit e shoqërisë anonime “Sheqeri” në Maliq, të cilët kanë dalë të papunë gjatë periudhës 1.11.1996 gjer më 31.3.1997, përfitojnë të drejtën e trajtimit për një vit me pagën e vendit të fundit të punës, sipas zbërthimit që shoqëria i ka bërë pagës mesatare mujore për efekt kontrolli, të miratuar për vitin 1996 e në vazhdim, por kjo pagë mesatare, mbështetur në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.389, datë 12.7.1995, nuk duhet të jetë mbi 7 mijë lekë në muaj.

2. Përfitojnë nga ky vendim punonjësit që kanë qenë të punësuar në sektorët e shoqërisë anonime “Sheqeri” në Maliq në mënyrë të pandërprerë, në një periudhë kohe jo më pak se një vit dhe ndodhen të punësuar në këta sektorë gjatë periudhës 1.11.1996 gjer më 31.3.1997.

Të drejtën e trajtimit e kanë punonjësit që nuk zhvillojnë veprimtari ekonomike në formën e punësimit a të vetëpunësimit, nuk kanë tokë të mjaftueshme në pronësi ose përdorim, si dhe janë të gatshëm e pranojnë të marrin pjesë në punë të nevojshme publike të organizuara në nivel lokal.

Këta punonjës përfitojnë të gjitha kompensimet sipas dispozitave në fuqi.

3. Fondet financiare prej 40 milionë lekësh për kryerjen e pagesave të punonjësve sipas këtij vendimi, si dhe për pagesat ndaj sigurimeve shoqërore, përballohen nga buxheti i Ministrisë së Punës dhe i Çështjeve Sociale për vitin 1997.

4. Periudha e trajtimit të punonjësve sipas këtij vendimi quhet vjetërsi pune për efekt pensioni dhe shënohet si e tillë në librezën e punës. Për punonjësit e trajtuar me këtë pagesë derdhen të gjitha llojet e kontributeve, siç përcaktohet në ligjin nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”.

5. Pagesat kryhen nga zyrat e punësimit të rretheve, duke u mbështetur në një dokumentacion të caktuar, i cili përcaktohet me udhëzim të veçantë.

6. Punonjësit që janë të trajtuar një herë sipas kritereve të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.420, datë 15.8.1994, nuk do të përfitojnë të drejtën e trajtimit sipas kritereve të këtij vendimi.

7. Ngarkohen Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale, Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit dhe Ministria e Privatizimeve të nxjerrin udhëzimin përkatës në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi